

## RRËFIMTARËT E KUTELIT

Gëzim ALIU  
Intituti Albanologjik  
Prishtinë

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Në vitet para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, Mitrush Kuteli boton disa libra me tregime. Përveç gjuhës së këndshme, rrëfimit të ngjarjeve e storieve, përshkrimeve, ndërtimit të atmosferës, aftësisë për ta përfshirë lexuesin në botën fikzionale që ndërton, veçanti kryesore e tregimeve të tij është përdorimi i rrëfimitarëve. Në këtë punim merremi me hetimin dhe analizimin e tipave të rrëfimitarëve (narratorëve), të një numër tregimesh të Kutelit. Kur rrëfimtari në një tregim është edhe personazh, pra gjendet brenda botës së rrëfyer, atëherë, në këtë punim domosdo që herë pas here shprehim edhe mendime e vlerësime për personazhet, kryesisht për veprimet e tyre, por edhe psikologjinë.

**Fjalë çelësa:** Kuteli, rrëfimtari, tregimi, historia, personazhi, veprimi, psikologjia

### Hyrje

Mitrush Kuteli është ndër shkrimtarët e rëndësishëm të asaj që e quaj periudhë e stabilizimit artistik të letërsisë shqipe. Gjatë viteve 1929 deri më 1944, Kuteli boton disa tregime dhe libra me tregime: “Vjeshta e Xheladin Beut” (tregim), 1929; “Netë shqipëtare” (tregime), 1938; “Ago Jakupi e të tjera rrëfime” (tregime), 1943; “Kapllan Aga i Shaban Shpatës” (tregime),

1944. Veçanti e të gjitha tregimeve të Kutelit është rrëfimtari, çka e dallon nga të gjithë autorët bashkëkohanikë, madje, mund të them edhe nga autorët e mëpastajmë të prozës shqipe.

Por, çka është rrëfimtari (narratori)?

Në një përgjigje të shkurtër, mund të thoshim se rrëfimtari është dikush a diçka që e rrëfen një ngjarje apo disa ngjarje që lidhen dhe e ndërtojnë një histori të caktuar. Mirëpo, nuk është kaq e thjeshtë, sepse po të ishte kështu nuk do të teorizohej për rrëfimtarin që nga Antika (Platoni e Aristoteli) e deri më sot.

Më poshtë po e bëj një përpjekje për ta përmbledhur teorikisht përgjigjen për pyetjen e mësipërme.

Teoria e Gérard Genette-it për rrëfimtarin (narratorin) është thelbësore kur flasim për këtë kategori narrative. Sipas këtij teoricieni, zgjedhja e romancierit nuk është mes dy trajtave gramatikore, por mes dy qëndrimeve narrative, ku trajtat gramatikore janë thjesht pasojë automatike: "...ta kesh storien e treguar nga njëri prej personazheve apo ta kesh të treguar nga një narrator jashtë stories".<sup>1</sup> Kështu, Genette, duke hequr dilemat gramatikore, pasi, sipas tij, nëse nisemi nga gramatika, secili narrator nisët nga veta e parë, bën pyetjen: "Pyetja e vërtetë është nëse mundet apo nuk mundet narratori të përdorë vetën e parë për të emërtuar *ndonjërin nga personazhet e veta*"?<sup>2</sup> Pas kësaj pyetjeje, ai bën dallimin mes dy tipave të narrativës: "...njëra ku narratori mungon në storien që e rrëfen (shembull: Homeri në *Iliadë* apo Floberi në *Edukimi sentimental*), kurse tjetra ku narratori është i pranishëm si personazh në storien që e rrëfen (shembull: *Gil Blas* apo *Wuthering Heights*). Tipin e parë e quaj, për arsye të qarta, *heterodiegetik* dhe të dytin tip *homodiegetik*".<sup>3</sup> Por, shpjegon Genette duke marrë shembuj nga veprat letrare të përmendura, çështja nuk mbyllet me kaq dhe nuk është kaq e thjeshtë: te Homeri e Floberi narratori mungon totalisht te narrativat përkatëse, por te narratori homodiegetik ka shkallë të pranisë: derisa *Gil Blas* është hero i pakontestueshëm i stories që rrëfen, Lockwood-i pakontestueshëm nuk është. Genette shprehet: "Mungesa është absolute, por prania ka shkallë".<sup>4</sup> Prandaj, vazhdon ai: "Duhet të bëj diferencime brenda tipit homodiegetik për së paku dy varietete: i pari ku narratori është hero i narrativës së vet (*Gil Blas*) dhe tjetra ku ai e luan vetëm një rol

<sup>1</sup> Gerard Genette, *Narrative Discourse, An Essay in Method*, Cornell University Press, Ithaca, New Yoork, 1980, f. 244.

<sup>2</sup> Po aty, f. 244.

<sup>3</sup> Po aty, f. 244-245.

<sup>4</sup> Po aty, f. 245.

dytësor, që pothuajse gjithmonë del të jetë rol vëzhguesi dhe dëshmitari: Lockwood, narratori anonim i Louis Lambert, Ishmael në *Moby Dick*, Marlow në *Lord Jim*... Thuajse është sikur narratori nuk mund të jetë një i rëndomtë në narrativën e vet: ai mund të jetë vetëm ylli apo një soditës i thjeshtë. Për varietetin e parë (gjë që deri diku paraqet shkallë të fortë të homodiegjesës), ne do ta rezervojmë termin e pashmangshëm autodiegjetik”.<sup>5</sup> Më tutje, Genette paraqet katër tipat themelorë të statusit të narratorit: “Nëse në secilën narrativë e përcaktojmë statusin e narratorit edhe nga niveli narrativ (ekstra-apo intradiegjetik) edhe nga relacioni me storien (hetero-apo homodiegjetik), ne mund t’i paraqesim katër tipa themelorë të statusit të narratorit: (1) ekstradiegjetik-heterodiegjetik – paradigma: Homeri, narrator në shkallën e parë, që e tregon storien ku nuk është i pranishëm; (2) ekstradiegjetik-homodiegjetik – paradigma: Gil Blas, narrator i shkallës së parë që e tregon storien e vet; (3) intradiegjetik-heterodiegjetik – paradigma: Sheherzadja, narrator në shkallën e dytë që tregon storie në të cilat plotësisht është e papranishme; (4) intradiegjetik-homodiegjetik – paradigma: Uliksi në Librat IX-XII, narrator në shkallën e dytë që e tregon storien e vet”.<sup>6</sup>

Nëse teorisë së Genette-it ia bëjmë një modifikim të vogël, narratori është:

Instancë rrëfyese, jo pjesëmarrës në botën e rrëfyer, pra pa tipare të identifikueshme (ose, pa *identitet*) dhe

Instancë rrëfyese pjesëmarrëse në botën e rrëfyer, pra me tipare të identifikueshme (me *identitet*).<sup>7</sup>

Tipi i parë është, siç e pamë te Genette, i mungesës absolute.

Tipi i dytë, pjesëmarrës, i identifikueshëm përmes tipareve që shquhen në botën e rrëfyer, mund të jetë:

-i zbehtë - thjesht vëzhgues, dëshmitar ose ri-rrëfyes i të dëgjuarave;

-i pjesshëm - vëzhgues e dëshmitar në marrëdhënie me heroin (narratori mund të ketë ‘jetë’ të vet, madje të rëndësishme në rrjedhën e stories);

-i plotë - hero i stories së vet.

Duke u nisur nga teoria e Genette-it, por duke u bazuar te modifikimi që bëmë, më poshtë i hetojmë dhe i analizojmë rrëfimet e Kutelit.

<sup>5</sup> Po aty, f. 245.

<sup>6</sup> Po aty, f. 248.

<sup>7</sup> Mieke Bal, *Narratology, Introduction to the Theory of Narrative* (second edition), University of Toronto Press, Toronto, Buffalo, London, 1997, f. 19.

## Rrëfimtari autorial i “Xheladin Beut”

Nga dy shembuj të shkurtër shkëputur nga tregimi i gjatë “Vjeshta e Xheladin Beut”,<sup>8</sup> mund ta përcaktojmë shpejt se përmes çfarë tipi rrëfimtari autori e ndërton historinë e beut.

As vetë Xheladin Beu nuk dinte përse ndjente një zbrazëturë aq të madhe në zemër atij mëngjesi vjeshte të dytë. Një zbrazëturë sa një zgërbonjë gështenje që e ka brejtur krymbi përbrenda, një shembëturë, një turbullirë e një neveritje pa fund e pa anë...<sup>9</sup>

...

Xheladin Beu i Shemshedin Beut të Xheladin Pashait, apo “Beu i madh”, siç i thosh tërë bota, zot i patundur mbi çifligje e mbi njerëz, ndjente një zbrazëturë të madhe në zemër. Gojën e kish të hidhur sikur të paskej ngrënë shafran, qiellzën të thatë, gjuhën të trashë si shuall bualli. Dhe herë-herë, një të therur në tepelekun e kokës.<sup>10</sup>

Nga këta dy paragrafë, shihet që rrëfimtari i di të gjitha për beun, madje edhe për shijen në gojë e dhembjen në kokë. Pra, “Vjeshta e Xheladin Beut” e Mitrush Kutelit, rrëfëhet përmes rrëfimitarit jo pjesëmarrës në botën e rrëfyer, por që di shumë, natyrisht, sepse pozita e tij ‘jashtë’ ia mundëson këtë. Rrëfimtari i stories së Xheladin Beut është edhe bartës i qëndrimeve etike autoriale, pra kemi ndërhyrje të autorit të nënkuptuar, kështu që del rrëfimtari autorial.

## Rrëfimtarët e netëve shqiptare

Në veprën “Netë shqipëtare”<sup>11</sup>, në një pjesë të mirë të tregimeve, përdoret veta e parë. Por, të shohim cili është niveli i pjesëmarrjes së rrëfimtarëve në storiet e rrëfyera.

“Përtej valëvet të kohës” është tregim që ndërtohet përmes rrëfimitarit pjesëmarrës, me identitet të plotë, i cili rrëfen për ëndrrën që e dërgon në kohën e Kastriotit, ka emrin Rodovan i Vllastar Katjelit, që e do Engjëllinën dhe bëhet gati për luftë. Por, zhvillimi i mëturshëm i historisë së tij ndërpritet nga këputja e ëndrrës në *kohën e tashme*. Kjo ndërprerje ndodh

<sup>8</sup> Mitrush Kuteli, *Prozë dhe vargje të zgjedhura 1*, Botimet Kuteli, Tiranë, 2009.

<sup>9</sup> Po aty, f. 55.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Mitrush Kuteli, *Net shqipëtare* (rrëfime), Bukuresht, 1938.

për shkak të ndërhyrjes së autorit të nënkuptuar, pra tregimi është ideologjik dhe kështu nuk synohet rrëfimi i veprimit, por paraqitja e idesë.

Ndërkaq, në “Kujtimet e kujtimeve (natë gushti)”<sup>12</sup> kemi dy rrëfimtari: i pari, që e hap tregimin, është një kurbetçar me emrin Postol, por me identitet të zbehtë. Rrëfen pak për veten, pra nuk është hero i historisë që rrëfëhet më vonë. Rrëfimtari i dytë është anëtari i një familjeje të mërguar qëmoti në Vllahi, ku gjenden shqiptarët që punojnë dhe e ndërtojnë këtë vend. Ky personazh, të cilin kurbetçarët e quajnë Ago Dajlani i Padinës, është Marko Arbënashi dhe fillimisht e tregon historinë e gjyshit të vet, ikjen e tij nga Peshkëpia, vdekjen në dhé të huaj, pastaj si kishte udhëtuar në atdhe për t’ia varrosur eshtrat sipas amanetit të tij e si kishte dëgjuar këngën për trimëritë e Bendo Shapërdanit. Në çastin që Marko fillon të rrëfejë për Bendon, duke u mbështetur në këngën dhe të dëgjuarat për personazhin kryesor të këtij tregimi, shndërrohet në rrëfimtari të vetës së tretë, jo pjesëmarrës në historinë e rrëfyer. Kështu, për botën e rrëfyer të kohës së Bendos, ky rrëfimtari nuk ka identitet, sepse nuk është pjesëmarrës, ndërkaq në botën e rrëfyer të rrëfimitarit të parë (Postolit) ka identitet të zbehtë. Edhe për këtë, po sikur për Postolin, marrim vesh pak gjëra nga *jeta* e tyre. Këta dy rrëfimtari kryejnë funksionin e rrëfimit të historisë së Bendos. I pari na çon te Marku, kurse ky te historia e Bendos.

Ndërkaq, në tregimin “Natë listopadhi”, rrëfimtari, nga pozita e të rriturit, rrëfen si e kishte dëgjuar Gjyshin duke rrëfyer për historinë e kërkimit të thesarit (“haznën e Rrapsallit”). Kemi kështu rrëfimtarin pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, fëmijë shtatë a tetë vjeç, gjendur pranë gjyshit të tij, i cili, nga personazh, shndërrohet në rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të plotë, hero i stories që ua rrëfen të tjerëve në rrethin e parë të rrëfimit ku gjendet edhe nipi i tij. Por, rrëfimi i tij varet pashkëputshëm nga ndërgjegjja e rrëfimitarit të parë, fëmijës pra, të cilin ndërkohë e merr gjumi<sup>13</sup>. Plotësimi i mëtejme i stories bëhet përmes copëzave të dialogëve. Lexuesi, ashtu sikurse rrëfimtari i parë (fëmija), nuk e merr vesh se ç’kishte ndodhur, mirëpo nëna i thotë në fund se mustaqe-verdhi (personazh në historinë e gjyshit) ishte prishur nga mendtë dhe të lidhur e kishin dërguar në Shën Naum (f. 66). Kështu, kemi dy rrëfimtari: i pari me identitet të zbehtë, i dyti me identitet të plotë. Por, përmbyllja e stories varet nga rrëfimtari që e

<sup>12</sup> Autori, në fund të librit sqaron se është *Natë qershori*, pra e përmirëson gabimin në këtë mënyrë, shih “Netë shqipëtare”, vep. e cit., f. 179.

<sup>13</sup> Kuteli, *Net shqipëtare*, vep., e cit., f. 63-64.

nis tregimin. Edhe pse me tipare të zbehta, ka fuqi përcaktuese në strukturën rrëfimtare.

Në “Natë kollozhegu”, rrëfimi fillon në vetën e parë, në shumës, e kemi një rrëfimtari që është pjesë e grupit, me identitet të zbehtë:

Kur do nisim të ngjitëm të përpjetën e Bushit Xha Martini mbajti kuajt e më t’u hoth poshtë me një-herë, sikur ish djalë njëzet e një mot.<sup>14</sup>

Por, ndërkohë, Xha Martini ‘ndahet’ nga grupi dhe shndërrohet në rrëfimtari. Pjesëmarrësit në rrethin e parë të rrëfimit ndodhen në hanin e Olloman Beut, është natë e ftohtë, çlodhen nga udhëtimi i mundimshëm nëpër fërfëllizë. Pasi fillojnë të pinë verë, në një çast, një nga të pranishmit e bën një pyetje aktivizuese, që e shtyn rrëfimin përpara, pra e nxit rrëfimtarin (Xha Martinin) të rrëfejë:

-Ky na qënka Hani i Olloman Beut... E pse i thënkkan vallë Hani i Olloman Beut?<sup>15</sup>

Më tutje, Xha Martini e rrëfen historinë e beut mizor:

Ka qënë-o një kohë këtu kur edhe foshnjëzat e djepit dinin ç’është embri Olloman Be, se embri Olloman Be edhe fjala frikë ishin një e një...<sup>16</sup>

Kështu, kemi dy rrëfimtari, të dy me identitet të zbehtë. I pari na dërgon te Xha Martini, kurse ky te historia e Olloman Beut. Për rrethin e parë të rrëfimit (hani), Xha Martini është pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, siç e thamë, por për rrethin e dytë (Olloman Beu) është jo pjesëmarrës, pa identitet, i vetës së tretë, madje edhe me aftësi të mëdha rrëfimtare.

Edhe tregimi “Xha Brahua i Shkumbanicës”, fillon në vetën e parë shumës:

Që kur gjelbëronin shelgjishtat e jazit e gjer ndryshkeshin e binin fletët e pjergullave të mullirit, **ne vegjëlija** (nënvizim imi, GA) e fshatit ishim dit’ për ditë e ças për ças mysafirët e pa fuar të Xha Brahos të Shkumbanicës...<sup>17</sup>

Rrëfimtari i parë është një kurbetçar: “...pas kaqe gjëmë mërgimi...” (f. 90), pjesëmarrës, me identitet të zbehtë: rrëfen për veten fëmijë, por jo

<sup>14</sup> Po aty, f. 67.

<sup>15</sup> Po aty, f. 72.

<sup>16</sup> Po aty, f. 73.

<sup>17</sup> Po aty, f. 90.

për ndonjë histori ku është kryesori; rrëfen për tragjedinë e Xha Brahuas. Është pra rrëfimtari vëzhgues, dëshmitar. Vetë titulli e përcakton këtë nivel përfshirjeje të tij në historinë e rrëfyer. Përfshirja është emocionale, jo e veprimit. Ai dhe fëmijët e tjerë, në fund të tregimit, nuk arrijnë ta shpëtojnë Xha Brahan nga vërshimi që rrënon mullirin dhe mbyt të zotin brenda tij.

Titulli i tregimit “Rrëfimi i parë i Argjir Vlonjatit (Natë muaji Shëmbitër)” sugjeron se rrëfimtari do të jetë një personazh me emrin Argjir. Është e vërtetë, por, ky personazh nuk haset menjëherë si rrëfimtari. Tregimin e hap një tjetër rrëfimtari, me emrin Mitrush, që na dërgon te Argjiri. Kemi kështu dy rrëfimtari: i pari është pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, kurse i dyti është po ashtu pjesëmarrës, por me identitet të plotë, është hero i stories që e rrëfen. Sikur te disa tregime të mësipërme të kësaj vepre të Kutelit, rrëfimtari i parë nuk rrëfen për historinë e vet, por të dikujt tjetër. Pra, deaktivizohet (me ndonjë ndërhyrje të kohëpaskohshme të shkurtër), duke e lënë personazhin kryesor (Argjir Vlonjatin) të rrëfejë historinë e vet.

Në tregimin “Gjonomadhe e Gjatollinj (Sefedin Sefedini)”, ndonjë rrëfimtari i referohet vetes, ka tipare të rrëfimit të vetës së tretë, me aftësi të mëdha narrative. Lë përshtypjen e pranisë në botën e rrëfyer si personazh, kurse në të vërtetë është rrëfimtari jo pjesëmarrës, pa identitet. Në fillim të tregimit, shprehet:

... Unë u flas me të drejtën e Zotit e me dorë në zembër se ja! u thinja, sot jam e nesër jo e s’dua të marr për n’atë jetë një gur mulliri në grykë...<sup>18</sup>

Për këtë rrëfimtari marrim vesh se është ‘i thinjur’ dhe që nuk dëshiron të marrë edhe një ‘mëkat’ në jetën tjetër: një detaj fizik dhe një detaj etik, jo diçka më tepër. Por, kjo nuk është e rëndësishme, sepse ai nuk rrëfen për veten. Nuk është veprues, pra pjesëmarrës në botën për të cilën rrëfen, por të cilën e njeh mirë. Dhe, kërkon ta besojmë rrëfimin e tij, po sikur të ishte vëzhgues e dëshmitar i ngjarjeve.

Edhe në tregimin “Lugetërit e fshatit tonë”, kemi rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, sepse nuk rrëfen për veten, por për lugetërit e fshatit të vet. Rrëfimin për të tjerët (njerëzit që kanë telashe me lugetërit) e realizon përmes disa mënyrave: për përjetimin e Hajros, të rrëfyerit ia lë këtij në dorë, pra ky personazh shndërrohet përkohësisht në rrëfimtari. Për storien e Komi Poçarit, fillimisht nuk i bie ndërmend kush ia kishte rrëfyer (por, e kishte dëgjuar dy a tri herë), ndërkaq pak më vonë thotë: “... ngjarjen

<sup>18</sup> Po aty, f. 133.

e Komit m'a ka rrëfyerë Nën' e Stefanit që e ndjeu Zoti Marsin që shkoj” (f. 164). Mirëpo, është e natyrshme, gjatë rrëfimit, rrëfimtari pjesëmarrës merr tipare të rrëfimitarit jo pjesëmarrës, me aftësi të mëdha narrative, për shembull: “-Qënkam në varret, tha Komi me mëndje” (f. 167); pra, rrëfimtari e di se çfarë mendon personazhi. Edhe storien e Belulit të cilit i vdes e shoqja dhe ngrihet nga varri shkaku i mallëngjimit, e rrëfen në këtë mënyrë, duke iu referuar dikujt: “Ja, flitet edhe sot në fshat se dikur u pat ngjallur një nuse e re nga malli i një trimi...” (f. 168-169). Po ashtu edhe për storien kryesore të këtij tregimi, të dashurisë së madhe të Zef Kanxhallozit për Dafinën e bukur, i cili “U ngjall lugat nga malli i Dafinës” (f. 171), i mjafton një referim “... si rrëfente një i njohur...” (f. 170) për të vazhduar pastaj rrëfimin në vetën e tretë, duke përdorur aftësitë që mundëson kjo vetë rrëfimi.

### Ago Jakupi e të tjerët

Në ndonjë tregim të Kutelit, në shikim të parë duket sikur rrëfimtari është i pranishëm në botën e rrëfyer, por, në të vërtetë, nuk është pjesëmarrës. Më lart e përmendëm rrëfimtarin në tregimin “Gjonomadhe e Gjatollinj (Sefedin Sefedini)”, që në fillim i referohet vetes, por shihet që nuk është pjesëmarrës, rrëfen në vetën e tretë dhe di gjithçka për storien e rrëfyer. Edhe në tregimin “Vjeshta e Xheladin Beut”, duket sikur rrëfimtari gjendet në botën e rrëfyer, sikur është njëri nga personazhet, por nuk është, pra kemi rrëfim në vetën e tretë, jo pjesëmarrës në botën e rrëfyer. Përshtypje të tillë lë edhe te tregimi “Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”, në veprën “Ago Jakupi e të tjera rrëfime”.<sup>19</sup> Edhe në këtë tregim rrëfimtari është jo pjesëmarrës, pa identitet, por duket sikur “jeton” si personazh në ambientin për të cilin rrëfen. Kjo përshtypje ndoshta rrjedh edhe nga shkaku se autori, në fillim, ia dedikon të atit librin me tregime dhe shprehet se “Shumë nga fjalët e kësaj vepre janë fjalët e tij”.<sup>20</sup> “Rrëshqitja” e tillë narrative nuk e cenon strukturën e motivimit. Do ta cenonte po të përfshihej rrëfimtari në storie. Pra, në njërën anë të ishte rrëfimtari-personazh vëzhgues e dëshmitar,

<sup>19</sup> Mitrush Kuteli, *Ago Jakupi e të tjera rrëfime*, Botim i autorit, Tiranë, 1943.

<sup>20</sup> Aurel Plasari shprehet se tregimtari, “... me ndihmën e disa përftesave, orvatet të krijojë përshtypjen e një të treguari të drejtpërdrejtë, shprehje e improvizimit”; për më tepër shih: Aurel Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Apolonia, Tiranë, 1995, f. 33.

e në anën tjetër të dinte në hollësi për heroin, madje edhe për hidhësinë në gjuhë të Xheladin Beut apo për ëndrrat moralizuese të Ago Jakupit.

Ndërkaq, në tregimin “Vendosa të shkoj në Amerikë”, rrëfimtari është pjesëmarrës, me identitet të plotë, hero i stories së vet. Madje, rrëfimtari i drejtohet lexuesit (apo, sipas teorisë, narraterit, lexuesit të nënkuptuar):

Nusja ime kish shtatë vjet dhe i theshin Marinë (mund t’i thoshin edhe ndryshe, po kjo nuk u takon juve, si lëçitës.)<sup>21</sup>

Rrëfimtari në këtë tregim rrëfen për një pjesë të fëmijërisë së vet dhe të tërën e ndërton përmes kujtesës, pra kemi anakroni subjektive. Pozitash e rrëfimtari është pozita nga rrëfen. Pra, nuk është rrëfim nga perspektiva e fëmijës, në kohën e zhvillimit të stories. Kjo bën që ai të ndërhyjë me vetëdijen e ‘të rriturit’, që e ndikon tërë tregimin.

Edhe tregimi “Fije nga jeta e Theofil Kostorit” ka rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të plotë, hero i stories së vet:

Kjo që lëçitni është jeta ime.  
Vetë e rrojta, vetë e shkrojta.<sup>22</sup>

Por, Theofili, rrëfimtari me identitet të plotë, i vetës së parë, përveç që rrëfen e përshkruan për një botë të këndshme fëmijërie në një fshat të Shqipërisë, po ashtu rrëfen edhe përralla. Për shembull, pjesa e njëmbëdhjetë e këtij tregimi është e tillë, rrëfim përralle. Rrjedhimisht, kemi deaktivizim të rrëfimtari pjesëmarrës dhe aktivizim të rrëfimtari të vetës së tretë, jo pjesëmarrës, pa identitet.

Në këtë tregim të gjatë, rrëfimtari rrëfen për përjetimet e veta fëmijërore, rrëfen përralla, por rrëfen edhe për të tjerët që lidhen me të, ngjarje pas ngjarjeje, duke ndërtuar mozaik të pasur me shumë personazhe. Nganjëherë, kur rrëfen për histori ku është e pamundur të ketë qenë, arsyetohet dhe kështu e motivon rrëfimin:

... Këto që i them, nga sa i dëgjonja i them...<sup>23</sup>

<sup>21</sup> Kuteli, *Ago Jakupi e të tjera rrëfime*, vep., e cit., f. 28.

<sup>22</sup> Po aty, f. 43.

<sup>23</sup> Po aty, f. 77.

Këtu del një problem: rrëfimi për të tjerët, në cilësinë e vëzhguesit, dëshmitarit, ri-rrëfyesit të të dëgjuarave nga të tjerët, a nuk ia lëkund pozitën e rrëfimitarit-hero i stories së vet? Në shikim të parë mund të duket kështu, por, përfshirja e fuqishme emocionale, përmes kujtimeve të kthjellëta, megjithatë ia ruan pozitën e rrëfimitarit me identitet të plotë, hero i stories së vet. Po, sepse edhe të tjerët bëhen pjesë e botës së tij, në të vërtetë, pa të, rrëfimin e tij, të tjerët nuk do të ekzistonin në botën e rrëfyer.

Por, hero i stories së tregimit “Fshati im e pi rakinë...”, nuk është rrëfimtari. Heronj janë personazhet që e pinë fort rakinë dhe ai rrëfen për ta. Pra, rrëfimtari i këtij tregimi është pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, vëzhgues, dëshmitar dhe ri-rrëfyes i të dëgjuarave:

... u pat lënë shokëve me gojë të vdekjes që, si të vdesë, t’ a lajnë me raki, përpara se t’ a shtjenë në varr.

Si pat thënë, ashtu ia patnë bërë, se fjala e vdekjes nuk shkelet.

Tri ditë pas varrimi i kanë vajtur pastaj, atje ne varri, edhe i kanë derdhur një goxha-voze raki mi krye.

Edhe, rrëfejnë (Zoti që është një!) se i vdekuri e përpiu rakinë me një herë.

Se, ku t’ a dish, i shkreti ndofta priste gojë-hapur...<sup>24</sup>

Në veprën “Ago Jakupi...” janë edhe dy tregime interesante, ku gërshetohen elemente letrare dhe të udhëpërshkrimit, “Parvera në Transilvani” dhe “Në rrugë përtej Tiraspolit”.

Në tregimin “Parvera në Transilvani”, stória rrëfëhet nga rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të plotë, që qendër të kësaj proze të bukur e bën veten dhe të tjerët që lidhen me të, në një pjesë të jetës së vet të dikurshme.

Edhe në tregimin “Në rrugë përtej Tiraspolit”, stória rrëfëhet nga rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të plotë. Në këtë tregim, si në të mësipërmin, përshkrimi i hapësirës luan rol të rëndësishëm, meqë, siç e thamë, të dyja tregimet kanë elemente të udhëpërshkrimit. Edhe në këtë prozë, rrëfimtari rrëfen për një pjesë të jetës së vet. Rrëfimtari, kuptohet, është autorial, është vetja e autorit real në një pikë të caktuar kohore e hapësinore.

### **Kapllan Aga i Shaban Shpatës**

Edhe te vepra “Kapllan Aga i Shaban Shpatës”<sup>25</sup>, Kuteli përdor rrëfimtari të ngjashëm si në dy veprat e mësipërme.

<sup>24</sup> Po aty, f. 101.

Rrëfimi në tregimin e gjatë “Natë prilli” fillon në vetën e parë shumës:

Derën e Kapllan Agës të Shaban Shpatës ne e kemi patur derë miku që nga pleqtë...<sup>26</sup>

Rrëfimi në shumës na bën të ditur se rrëfimtari që e hap tregimin është pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, pra nuk rrëfen ndonjë histori ku vetë është kryesori. Meqë Kapllan Agës pas shumë kohe i ishte kthyer i biri nga lufta, rrëfimtari, bashkë me të tjerë (prandaj flet në shumës), shkojnë ta vizitojnë. Në konakun e Agës pinë raki dhe fillojnë edhe rrëfimet. Në fillim rrëfen Destani, i biri i Kapllan Agës. Kështu, nga personazh shndërrohet në rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të plotë, sepse e rrëfen dhe e përshkruan përvojën në luftën ku kishte marrë pjesë. Rrëfimi i tij është i përmbledhur (shumë kohë në tri faqe) dhe kemi dy ndërprerje (nga Xha Ndini dhe nga Kapllan Aga). Ndërprerja e Kapllan Agës është më e gjatë, pastaj Destani e përmbyll rrëfimin e vet.

Pasi Destani e përfundon rrëfimin e historisë së vet, deaktivizohet nga rrëfimtari i parë:

Pas darke - e ç’darkë, për dyzet veta, jo për dymbëdhjetë sa ishim ne! - si na shtinë të lajmë duart, Kapllan Aga na ka hedhur nga shtatë a tet’ cigare për shoq...<sup>27</sup>

Pas disa sekuencave, rrëfimtari bëhet Kapllan Aga, që rrëfen disa ngjarje: një herë për profkat që ia bën xhaxhai për ta zbutur meqë nuk e kishte marrë me vete në luftë, ndërkaq, pak më tutje, fillon të rrëfejë një tjetër storie, që ka të bëjë me kërkimin e thesareve të fshehur. Pjesën e parë të saj e rrëfen Kapllan Aga, vazhdimin e rrëfen Xoxi pasi e nxjerrin nga gryka e thellë. Xoxi kështu shndërrohet në rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të plotë, sepse është hero i përjetimit të çuditshëm, mbinatyror, në galeritë e nëndheshme. Përmbylljen e stories së thesareve, ashtu siç e hap, e mbyll Kapllan Aga. Kurse, tregimin e mbyll rrëfimtari i parë:

Kur mbaroj fjalën Kapllan Aga i Shaban Shpatës, Xha Ndini përsëriti si nëpër ëndër fjalët e tij të fundit.

-Hajde, kohë, hajde...

<sup>25</sup> Mitrush Kuteli, *Kapllan Aga i Shaban Shpatës* (rrëfime, rrëfenja), botim i autorit, Tiranë, 1944.

<sup>26</sup> Po aty, f. 7.

<sup>27</sup> Po aty, f. 19-20.

...  
Ish heshtje në shtëpi edhe dëgjohej që fellë, në natë, ushëtima e Shkumbiut që përpiqej nëpër gurë.<sup>28</sup>

Siç shihet, kemi katër rrëfimtari në këtë tregim të Kutelit: Rrëfimtari që e hap tregimin dhe e bart të rrëfyerit të tjerët, është pjesëmarrës, por me identitet të zbehtë; Destani, i cili e rrëfen historinë e vet në luftë, pra në të është pjesëmarrës, me identitet të plotë; Kapllan Aga, rrëfimtari pjesëmarrës, me identitet të pjesshëm dhe Xoxi, për storien që e rrëfen, me identitet të plotë. Përdorimi i katër rrëfimtariëve në një tregim tregon për aftësitë rrëfimtari të Mitrush Kutelit, sepse askund nuk kemi rrëshqitje të strukturës së motivimit.

Në tregimin “I vdekuri edhe i gjalli”, historia e të vdekurit dhe të gjallit, rrëfëhet nga rrëfimtari jo pjesëmarrës, pa identitet, që i ka të gjitha aftësitë që mundëson kjo mënyrë rrëfimi, mirëpo, po sikur në disa tregime të tjera të Kutelit, për të cilët folëm më lart, e lë përshtypjen sikur është brenda botës së rrëfyer, sikur është i pranishëm, për shembull, kur lutet (“hej, vëntë dorë e na shpëtoftë!”, f. 43).

Rrëfimtari jo pjesëmarrës, pa identitet, e rrëfen edhe historinë e Rinë-Katerinëzës së gjallë dhe Kirolojt të vdekur, me të cilin martohet, në tregimin “Rinë-Katerinëza”. Është histori tragjike me fund të lumtur, meqë ky paradoks mundësohet nga ekzistenca e botës së përtej varrit, ku Kiroloj i merr të ëmën, Rinën dhe foshnjën.

“Unë, Çuli e Marina” është sikur vazhdim i tregimit “Vendosa të shkoj në Amerikë”, që gjendet në veprën “Ago Jakupi...”, pra edhe rrëfimtari është i njëjti, pjesëmarrës, me identitet të plotë, hero i stories që rrëfen:

Unë u sgjova, po kisha një bosh në shpirt (ja! shpirtin e kisha të vogël, po boshin e math!).<sup>29</sup>

Ndihet bosh sepse ka prishur martesën me “gruan” e tij, Marinën. Megjithatë, aftësia e tij për të bërë fluska nga shkuma e sapunit, ia sjell Marinën prapë. Është tregim për dashurinë mes fëmijëve që luajnë role të mëdhenjsh.

Edhe tregimi “Fije nga jeta e Theofil Kostorit” është vazhdim i tregimit me të njëjtin titull që gjendet në veprën “Ago Jakupi...”. Pra, edhe

<sup>28</sup> Po aty, f. 37.

<sup>29</sup> Po aty, f. 70.

rrëfimtari është i njëjti, Theofili apo Tërfili, siç e quajnë, rrëfimtar pjesëmarrës, me identitet të plotë, që në vazhdimin e tregimit rrëfen për zakonet e pjekjes së një kulaçi me emrin ‘rusa’ (pjesa “Rusa-papusa”), për një personazh me emrin Babalja, (pjesa “Babalja”) një plak interesant, i cili për herë të parë e kishte quajtur Tërfil (kur plaku tashmë ishte i verbër dhe i njihte të vegjëlit vetëm përmes të prekurit). Kjo pjesë është homazh i Tërfilit për Babaljen e shpirtin e tij të bardhë. Në pjesën e tretë të tregimit, të titulluar “Të Vdekurit”, tematizohet vdekja në sytë e fëmijës. Thelbi i kësaj pjesë është biseda filozofike që fëmija bën me të ëmën për vdekjen.<sup>30</sup> Ndërkaq, në pjesën e fundit të këtij tregimi, me nëntitullin “E bukur’ e Detit”, nëna ia rrëfen Tërfilit përrallën e të bukurës së detit, i cili e ndërprente kohë pas kohe me pyetjet e tij. Kështu, nëna shndërrohet në rrëfimtar jo pjesëmarrës, pa identitet (pra, për botën e përrallës).

### Përfundim

Në këtë punim, duke u nisur nga teoria e Gerard Genette-it, por duke u mbështetur në modifikimin që ia bëmë, hetuam dhe analizuam rrëfimtarët në një varg tregimesh të disa veprave të Mitrush Kutelit të botuara para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në një pjesë të madhe të tregimeve, e hasim një rrëfimtar që fillon të rrëfejë, por jo për veten: rrëfen ndonjë histori që e ka dëgjuar ose e ka përjetuar si vëzhgues e dëshmitar, por nganjëherë edhe për një personazh tjetër që gjendet në rrethin e tij të rrëfimit e që ndërkohë fillon të rrëfejë për një rreth tjetër, për një histori tjetër. Këta janë rrëfimtarë pjesëmarrës, me identitet të zbehtë, të pjesshëm e nganjëherë edhe të plotë: pra, rrëfimtari i parë e hap tregimin, por pak më vonë ia dorëzon të rrëfyerit një tjetri që rrëfen për ‘jetën’ e vet. Mirëpo, në tregimet e Kutelit kemi edhe rrëfimtarë të vetës së parë, që e hapin tregimin, janë pjesëmarrës në botën e rrëfyer, kanë identitet të plotë, heronj të storieve të tyre. Megjithatë, ndodh nganjëherë që të tillët e ndalin rrëfimin për veten dhe kallëzojnë përralla, por rrëfejnë histori edhe për të tjerët, me të cilët ndërlidhen në ndonjë mënyrë, përmes veprimit ose përfshirjes emocionale. Në disa tregime kemi përdorim të rrëfimit klasik të vetës së tretë, por nganjëherë, sidomos në fillim, duket sikur janë të pranishëm në botën e rrëfyer. Megjithatë, pak më vonë shihet që nuk janë, është vetëm përshtypje që krijohet nga përdorimi ‘folklorik’ i mënyrave të të rrëfyerit.

<sup>30</sup> f. 100-101.

Gërshetimi i rrëfimitarëve në tregimet e Kutelit asnjëherë nuk e rrezikon strukturën e motivimit. Në ndonjë tregim kemi deri edhe katër rrëfimitarë, por rrëfimi i tyre brenda një tregimi është pjesë ‘natyrale’ e rrjedhës së stories apo storieve. Aktivizimi i një rrëfimtari duke e deaktivizuar një tjetër apo anasjelltas bëhet aq ‘lehtë’ e këndshëm, sa që lexuesi as që e vëren. Po flas për lexuesin që nuk synon analizë narratologjike. Ndërkaq, për lexuesin studimor jep material të mirë për analizë, siç besoj e dëshmuam më sipër.

## Literatura

BAL, Mieke, *Narratology, Introduction to the Theory of Narrative*, (second edition) University of Toronto Press, Toronto, Buffalo, London, 1997.

GENETTE, Gérard, *Narrative Discourse, An Essay in Method*, Cornell University Press, Ithaca, New York, 1980.

KUTELI, Mitrush, *Ago Jakupi e të tjera rrëfime*, Botim i autorit, Tiranë, 1943.

KUTELI, Mitrush, *Netë shqipëtare (rrëfime)*, Bukuresht, 1938.

KUTELI, Mitrush, *Kapllan Aga i Shaban Shpatës (rrëfime-rrëfenja)*, Botim i autorit, Tiranë, 1944.

KUTELI, Mitrush, *Prozë dhe vargje të zgjedhura 1*, Botimet Kuteli 4, Tiranë, 2009.

PLASARI, Aurel, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Apolonia, Tiranë, 1995.

## KUTELI'S NARRATORS

### Summary

In this paper, starting from Gerard Genette's theory, but making a small modification, we have identified and analyzed the narrators in a series of narratives of several works by Mitrush Kuteli published before and during the World War II. In a large part of the stories, a narrator starts the narration, but does not tell about himself. The narrator tell a story that he has heard or was a witness of it or simply a spotter, but sometimes he also narrates about another character who is in his circle of his narrative, who begins to narrate about another circle, about another story. These are participatory narrators: some of them have an undistinguished identity, some have a partial identity, and some of them have a complete identity. There is e situation when the first narrator opens the story, but a little later, he transfers the narration over to another who narrates about his 'life'. However, in Kuteli's stories we also find first-person narrators, who open the story, are involved in the narrated world, have a full identity, and are heroes of their stories. Nevertheless, sometimes happens that such characters stop telling stories about themselves and tell fairytales, but they also tell stories about others, to whom they relate in some way, by action or involvement of emotions. In some stories, we have the classic third-person narrator, but sometimes, especially in the beginning, it seems like they are participants in the narrated world. However, a little later, we see that is not the case, it is just the impression created by the use of 'folklore' nuances is the way of narration.

The interweaving of narrators in Kuteli's stories never jeopardizes the motivational structure. In some stories, we find up to four narrators, but their narration within a story is a 'natural' part of the flow of stories. The activating of one narrator by deactivating another or vice versa becomes so 'easily' and enjoyable that the reader does not even notice it. I am talking about the reader who does not aim for narratological analysis. Meanwhile, for the analytical reader it gives a good material for analysis, as I believe we proved above.

